REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO
PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 24.10.2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/499

**R E P U B L I K A E K O S O V Ë S**

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

---

Kuvendi i Komunës
Nr.02/____
Datë: 19.10.2022

Në bazë të nenit 4,11, nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 14 par. 14.1, nenit 17 par. 17.1 shkronja (b,p dhe s), nenit 40 shkronja par.40.1 shkronja ( l ) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15 Qershor 2008, Statuti i Komunës së Malishevës, neni 3, 7, neni 10 par. 10.1 shkronja ( p ) par.10.2, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e shtatë (VII) të rregullt të mbajtur me datë: 18.10.2022 merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet, kërkesa e Lagjës së Mjekëve, nr. 02/252, dt.23.05.2022, për rregullimin e murit të varrezave publike në fshatin Shkozë, KK-Malishevës.

2.Bazuar në pikën e 1 të këtij vendimi, komunitetit të fshatit i lejohet që me mjete financiare të ndara nga ekonomit familjare, të realizojnë ndërtimin e murit mbrojtës të varrezave të fshatit Shkozë, KK- Malishevës.

3. Aktivitetet të cilat do të kryhen në kuadër të rregullimit të murit mbrojtës të varrezave të fshatit, si dhe vet muri mbrojtës nuk lejohet që të jetë pengesë, për rrugën publike, trotuaret apo interesat legjitime të palëve të treta.

4. Për zbatimin e këtij vendimi, autorizohet, kryetari i komunës së Malishevës, përmes drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësoro-juridik dhe drejtorisë për shërbime publike..

5.Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK), nr.10/2019 për shqyrtimin administrative të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaqi

Vendimi ju dërgohet:
1.MAPL-së ,
2.Drejtorive kompetente
3. Arkivit të Komunës

PRANUAR ME / ACCEPTED ON / PRIMLJENO: 27/01/2022
Nr.No.Br.: 02/152

# KËRKESË

NGA: LAGJJA E MJEKVE (SHABANHAJDINVE).
PERSON I AUTORIZUAR BESNIK BYTYQI.

PËR: KUVENDIN KOMUNAL - MALISHEVË

LENDA: KËRKESË PËR RREGULLIMIN E MURIT TË VAR.

DATA: 23.05.2022

JU DREJTOHEM ME KËTË SHKRESË - KUVENDIT KOMUNAL - MALISHEVË PËR RREGULLIMIN E MURIT TË VARREZAVE NË FSHATIN SHKOZË (ME MJETE VETJAK. QELLIMI I VETËM ËSHTË MOSOSHEMBJA E DHEUT, KU SI PASOJË DEMTOHEN EDHE VARREZAT.

KËRKESËN E BËJ ME QELLIM QË TË ME LEJO. PUNA NË PRONË PUBLIKE KOMUNALE.

NUK PENGOHET RRUGA, TRUTUARI DHE ASGJË PUBL.

KËRKESËS JA BASHKANGJESIM EDHE KOPJE PLANI TË PARCELËS SË VARREZAVE.

GJATSIA E MURIT ËSHTË RRETH 120 m

ANDAJ, KËRKOJ APROVIMIN NGA ASAMBLEA KOMUNAL PËR LEJIM TË PUNIMEV TË LARTCEKURA.